



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të dokumentave:

- **“Projekt-Rregullore Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”**
- **“Projekt Rregullore për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”.**

(Pjesë e dokumentacionit të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.15, datë 28.05.2026, për miratimin e Rregullores *“Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”*).

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, datë 14.11.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”. Dokumenti u publikua për konsultim publik në faqen zyrtare të AKEP gjatë periudhës 17.11.2025-16.12.2025.

Me vendimin nr. 4, datë 02.02.2026, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar për këshillim publik dokumentin “Për përcaktimin e metodologjisë për përlogaritjen e masës administrative me gjobë”. Procesi i konsultimit publik u zhvillua për një periudhë 30-ditore dhe përfundoi me datë 05.03.2026.

Në përfundim të procesit të këshillimit publik të dy projektakteve të sipërcituara, pranë AKEP janë depozitur komente vlerësime nga palë të interesuara, konkretisht:

- me shkresën nr. 1746 prot i AKEP, datë 10.12.2025, sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., mbi projektaktin “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”
- në datë 27.02.2026, në rrugë elektronike sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., mbi projektaktin “Për përcaktimin e metodologjisë për përlogaritjen e masës administrative me gjobë”.
- me shkresën nr. 357 prot AKEP, datë 06.03.2026, sipërmarrësi “One Albania” sh.a., ka mbi projektaktin “Për përcaktimin e metodologjisë për përlogaritjen e masës administrative me gjobë”.

Vlerësimi i komenteve është bërë në zbatim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

QËNDRIMI I AKEP MBI KOMENTET E SIPËRMARRËSIT “VODAFONE ALBANIA” SH.A.

- I. Lidhur me pikën 2, të nenit 11 “Urdhri i Inspektimit dhe njoftimi i tij te subjekti i inspektimit”, është propozuar që subjekti i përcaktuar në inspektim jo më vonë se 3 (tre) ditë, njoftohet paraprakisht nga kryetari i grupit të inspektimit, nëpërmjet një mesazhi elektronik (email) për inspektimin që do të kryhet, e cila bie ndesh me afatin e njoftimit 10 ditë të përcaktuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që, në pikat 1 dhe 3 të nenit 40 të ligjit nr. 99/2024, përcaktohet se:

“1. Inspektimi bëhet i ditur subjektit nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit me mjete elektronike (online) ose në forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në cdo rast, jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të procedurës së inspektimit.”

“3. Për inspektimet e parashikuara në shkronjen "a" të pikës 2 të këtij neni, inspektimi mund të realizohet pa njoftim pas marrjes së miratimit nga Inspektorati i Përgjithshëm”.

Për sa më sipër, propozohet si më poshtë:

1. Vendosjen në rregullore të afateve ligjore 10 ditore për njoftimin paraprak, sipas përcaktimeve ligjore, duke respektuar dhe parimin e hierarkisë së normave.
2. Të parashikohet në rregullore që: Për inspektimet e parashikuara në shkronjen “a” të pikës 2 të këtij neni, inspektimi mund të realizohet pa njoftim pas marrjes së miratimit nga Inspektorati i Përgjithshëm”, në mënyrë që të mos ketë disbalancim të procedurës administrative për rastet e mos njoftimit sipas pikes 2 të draft rregullores në rastet e mosnjoftimit.

Qëndrimi i AKEP: AKEP vlerëson propozimin për vendosjen e afatit 10 ditor përpara kryerjes së inspektimit por argumenton se afati 3 ditor i propozuar në projektregullore nga AKEP nuk bie ndesh me ligjin, për aq kohë sa dispozita ligjore nuk e ndalon shprehimisht një afat më të shkurtër dhe kur natyra e procedurës kërkon veprim të shpejtë administrativ. Parimi i hierarkisë së normave nuk cenohet, pasi rregullorja synon të konkretizojë mënyrën e zbatimit të procedurës në sektorin specifik të komunikimeve elektronike, ku dinamika e tregut dhe nevoja për reagim të shpejtë administrativ justifikojnë afate më të shkurtra.

Sa i përket propozimit nr. 2, dhe përfshirjen e pikës 3, të nenit 40 të ligjit nr. 99/2024, AKEP, sqaron se inspektimet pa njoftim paraprak janë të përcaktuara në pikën 2 të nenit 181 të ligjit nr. 54/2024 dhe rastet e kryerjes së inspektimeve pa njoftim paraprak, janë të përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të rregullores, prandaj dhe ky propozim nuk pranohet.

II. Lidhur me nenin 15 “Procesverbali i inspektimit”, pikat 2 dhe 5, bien ndesh me përcaktimet e pikave 1,2,3 dhe 7 të nenit 42 të ligjit nr. 99/2024, ku citohet se:

1. *“Trupa inspektuese, që kryen procedurën e inspektimit, mban procesverbalin e inspektimit”.*
2. *“Procesverbali i inspektimit nënshkruhet elektronikisht nga trupa inspektuese dhe subjekti i inspektimit në vendin e inspektimit dhe i njoftohet subjektit brenda 48 (dyzet e tete) orëve”.*
3. *“Në rast se subjekti i inspektimit e ka të pamundur nënshkrimin elektronik të procesverbalit të inspektimit, nënshkrimi i subjektit të inspektimit kryhet nëpërmjet tabletës ose mjeteve të tjera elektronike të përshtatshme për këtë qëllim”.*
7. *“Procesverbali i inspektimit përmban informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit, që të paraqese me shkrim apo në mënyrë verbale shpjegimet apo kundërshtimet e tij për faktet, rrethanat dhe gjetjet e pasqyruara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por në cdo rast jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, si edhe organin ku paraqiten këto shpjegime e kundërshtime”.*

Për sa më sipër, propozohet si më poshtë:

1. Pika 2, e këtij neni të draft Rregullores të rishikohet duke respektuar përcaktimet liqjore për plotesimin në vend të procesverbalit dhe jo kryerjen e këtij procesi nga zyra. Ligji përcakton që pamundësia vjen nga subjekti inspektuar, jo nga vete Inspektorati.
2. Në këtë nen të draft Rregullores të sanksionohet e drejta e subjektit të inspektuar për të dorëzuar brenda afatit 8 (tetë) ditor të kundërshtimeve dhe të mos mbahet përcaktimi i bërë në pikën 5 të nenit 15 të draft rregullores që nënshkrimi me rezerve është i mjaftueshëm sikur subjekti i inspektuar ka parashtuar kundërshtime

Qëndrimi i AKEP: AKEP, sqaron se kryerja e një kontrolli inspektimi në rast se paraqitet e nevojshme për verifikime të mëtejshme, që mund të lidhen edhe me verifikimin e elementëve teknike apo dhe verifikime të dokumentacionit, mund të mos përfundojë brenda ditës dhe vijimi i plotësimit të procesverbalit në zyrat e AKEP nuk e çënon subjektin objekt inspektimi, pasi ky procesverbal i njoftohet subjektit të inspektimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e përfundimit të këtij inspektimi. Për sa më sipër, ky sugjerim, nuk pranohet.

Lidhur me sugjerimin nr. 2 dhe sanksionimin e të drejtës për depozitimin e kundërshtimeve nga subjekti i inspektimit, jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga nënshkrimi/njoftimi i procesverbalit, AKEP, shprehet dakord dhe do ta reflektojë këtë sugjerim në rregullore.

III. Lidhur me përcaktimet e nenit 16 “Masat urgjente”, në gjykimin tonë, përcaktimet e këtij neni janë evazive, pasi nuk ekziston një Rregullore e miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm që rregullon procedurat për rastet e masave urgjente gjatë inspektimit. Në pikën 2, të nenit 46 të ligjit për inspektimin përcaktohet se: “Rregullat për kryerjen e procedurës së inspektimit me masë urgjente, me vendim të ndërmjetëm, miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm”.

Për sa më sipër, propozohet si më poshtë:

Heqjen e pikës 3 dhe 4 të nenit 16 (veçanërisht masat e përcaktuara në pikën 4) të draft Rregullores deri në miratimin e një rregullore nga Inspektori i Përgjithshëm për këto raste, pasi mund të kalohet në veprimtari jo proporcionale administrative, e cënueshme në kuptimin e nenit 17 dhe 109 të Kodit të Procedurës Administrative.

Qëndrimi i AKEP: Sa i përket heqjes së pikave 3 dhe 4 të nenit 16 të draft Rregullores, deri në hyrjen në fuqi të rregullores së Inspektoriatit të Përgjithshëm, sqarojmë se bazuar në përcaktimet e nenit 181 dhe 182 të ligjit nr. 54/2024, AKEP, ushtron veprimtarinë inspekutese në përputhje me

rregulloren e miratuar nga Këshilli Drejtues dhe ka kompetencë për të marra masa urgjente të cilat janë të detajuara në ligjin nr. 54/2024, dhe janë bërë pjesë në këtë projektakt, në pikën 4 të nenit 16 të draft Rregullores. Këto masa janë të lidhura ngushtë me sigurinë e spektrit të frekuencave, integritetin e rrjetit dhe interesit publik. Për këtë arsye, ky sugjerim nuk pranohet.

IV. Lidhur me përcaktimet e nenit 17 “Vendimi i ndërmjetëm”, ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se vendimet e ndërmjetme jepen vetëm për rastet e masave urgjente. Për rrjedhojë, dhe zbatimi i tij duhet të jetë në kuadër të një rregullore të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Në pikën 2 të nenit 46 të këtij ligji përcaktohet se: “Rregullat për kryerjen e procedurës së inspektimit me mase urgjente, me vendim të ndërmjetëm, miratohen nga inspektori i Përgjithshëm”

Për sa më sipër, propozohet si më poshtë:

Heqjen e këtij neni nga kjo Rregullore, pasi është abuziv dhe nga tipologjia e afateve të së drejtës së ankimit ngjan më tepër me një përcaktim të ligjeve proceduriale që rregullojnë veprimtarinë gjyqësore se sa atë administrative të një ogani publik. As vete Kodi i Procedurave Administrative nuk ka një rregullim të tillë për këto afate.

Qëndrimi i AKEP: Marrja e masave urgjente me vendim të ndërmjetëm sipas nenit 17 të kësaj draft Rregulloreje, sikurse sqaruam edhe më lartë, është e parashikuar shprehimisht në nenin 182 të ligjit nr. 54/2024. Po kështu, ky përcaktim është në harmoni të plotë me përcaktimet e nenit 46 të ligjit nr. 99/2024 i cili përcakton se: “*Trupa inspektuese gjatë procedurës së inspektimit ka të drejtë që me vendim të ndërmjetëm të marrë masa urgjente.....*”. Për këtë arsye, ky sugjerim nuk pranohet.

V. Lidhur me përcaktimet e nenit 21 “Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit”, pika 2 e tij, bie ndesh me disa përcaktime të ligjit për inspektimin dhe ligjit për kundërvajtjet administrative, konkretisht me:

- Pikën 2 të nenit 46 të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se: “*Rregullat për kryerjen e procedurës së inspektimit me mase urgjente, me vendim të ndërmjetëm, miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm*”.
- Nenin 23 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i cili citon se: “*Pezullimi i vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë. Në rastet kur ligji i posaçëm ka parashikuar procedure të ankimit administrativ dhe vendimi përfundimtar merret nga një organ administrativ me i lartë se organi administrativ, që ka nxjerrë vendimin e parë për kundërvajtjen administrative, atëherë ankimi administrativ pezullon ekzekutimin e aktit të parë të kundërvajtjes administrative, që ka parashikuar dënimin*

me gjobë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar".

- Kurse neni 185, i ligjit nr. 54/2024, parashikon “ankimin në Këshillin Drejtues të AKEP ndaj gjobës së vendosur nga inspektorët e AKEP, brenda 30 ditëve nga data e dhënies së saj. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ nga Këshilli Drejtues, përcaktohet në rregulloren përkatëse të AKEP, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative”.

Për sa më sipër, propozohet si më poshtë:

Në kushtet kur ligji i posaçëm parashikon procedurë ankimi dhe nuk ekziston një Rregullore për masat urgjente, Vodafone, sugjeron rishikimin e pikës 2 të draft Rregullores duke hequr të drejtën e organit publik për të ekzekutuar masat urgjente menjëherë, pasi është një veprimtari e paligjshme me pasojë pavlefshmëri në kuptimin e nenit 109 të Kodit të Procedurave Administrative

Qëndrimi i AKEP: Sa i përket heqjes së pikës 2 të nenit 21 të draft Rregullores, me pretendimin se ekzekutimi i menjëhershëm i masave urgjente është i paligjshëm, sqarojmë se neni 185 i ligjit nr. 54/2024, përcakton mundësinë e ankimit administrativ kundër gjobës së vendosur nga inspektorët. Ndërkohë që, ekzekutimi i menjëhershëm i masave urgjente është i lidhur me natyrën e tyre dhe efektin parandalues që kanë, vendosen me qëllim mbrojtjen e rrjetit, sigurinë kombëtare dhe të drejtat e përdoruesit fundorë dhe për më tepër janë të parashikuar në ligjin sektorial të komunikimeve elektronike. Megjithatë, neni 17 i projektregullores, ka përcaktuar të drejtën e ankimit edhe për masat urgjente të marra me vendim të ndërmjetëm, në momentin kur subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditësh, tek Këshilli Drejtues i AKEP. Referenca në nenin 23 të ligjit nr. 10479/2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, nuk qëndron, pasi kjo dispozitë i referohet masave ndëshkimore me gjobë dhe jo masave urgjente.

Për gjithë sa më sipër, propozimet nuk pranohen.

VI. Neni 9 – Fazat për përlllogaritjen e masës së gjobës.

➤ Interpretimi i niveleve të shkeljes dhe pesha e faktorëve rëndues/lehtësues.

Vodafone Albania sh.a., vëren se draft-rregullorja parashikon klasifikimin e shkeljeve në tre nivele (i ulët, i mesëm dhe i lartë) si dhe aplikimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues. Megjithatë, sipas operatorit, drafti nuk përcakton tregues objektivë sasiorë për kalimin nga një nivel në tjetrin, si p.sh. pragje të matshme për ndikimin e shkeljes, kohëzgjatjen e saj apo vlerën ekonomike të dëmit të shkaktuar.

Në mungesë të këtyre elementeve, sipas Vodafone Albania sh.a., ekziston rreziku që klasifikimi i nivelit të shkeljes të mbetet në diskrecion të gjerë interpretativ të strukturave inspektuese të AKEP, gjë që mund të cenojë parimin e proporcionalitetit dhe parashikueshmërinë e sanksioneve.

Për sa më sipër, Vodafone propozon që AKEP të konsiderojë:

- përcaktimin e treguesve objektivë për klasifikimin e niveleve të shkeljes;
- vendosjen e një kufiri maksimal kumulativ për efektin e faktorëve rëndues dhe lehtësues;
- hartimin e një udhëzuesi interpretimi për standardizimin e klasifikimit të shkeljeve.

➤ **Mungesa e shembujve ilustrues në metodologjinë e llogaritjes së gjobave.**

Vodafone Albania sh.a., vëren se draftrregullorja përmban formulën për llogaritjen e masës së gjobës, por nuk përfshin shembuj konkretë ose skenarë ilustrues për aplikimin praktik të saj.

Në praktikën rregullatore të disa vendeve të Bashkimit Evropian, autoritetet rregullatore përfshijnë në aktet përkatëse shembuj ilustrues që ndihmojnë në harmonizimin e zbatimit të metodologjisë dhe në reduktimin e divergjencave interpretative.

Vodafone Albania sh.a., thekson se mungesa e shembujve ilustrues mund të krijojë situata ku raste të ngjashme trajtohen ndryshe dhe operatorët nuk mund të parashikojnë në mënyrë të qartë rrezikun rregullator.

Për sa më sipër, Vodafone Albania sh.a., sugjeron që rregullorja të përfshijë një aneks me shembuj ilustrues për mënyrën e llogaritjes së gjobave.

➤ **Diskrecioni i strukturave inspektuese në përcaktimin e masës së gjobës.**

Vodafone Albania sh.a., vëren se sipas draft-rregullores struktura inspektuese e AKEP klasifikon nivelin e shkeljes dhe propozon masën përfundimtare të gjobës. Sipas operatorit, në mungesë të kriterëve më të detajuara metodologjike, kjo mund të çojë në një përqendrim të konsiderueshëm diskrecioni individual tek inspektori.

Për sa më sipër, Vodafone rekomandon përcaktim të kriterëve më të detajuara për klasifikim e kategorisë për përcaktimin e vlerës së gjobës, dhe një kufizim të qartë të efektit maksimal të faktorëve.

Qëndrimi i AKEP: AKEP vlerëson se në vijim të komenteve të ardhura për dokumentin “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”, këto janë janë konstruktive dhe synojnë përmirësim teknik të metodologjisë, por nuk identifikojnë mospërputhje ligjore me ligjin për komunikimet elektronike.

Metodologjia e gjobave që i bashkëlidhet rregullores për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, është në përputhje me ligjin nr. 54/2024 sepse masa e gjobave bazohet në përqindje të të ardhurave vjetore dhe për përcaktimin e tyre zbatohen kriteret si rëndësia e shkeljes, kohëzgjatja, historiku, lloji i dëmit të prodhuar, kriteret të cilat përbëjnë bazën për klasifikimin e shkeljes dhe përcaktimin e përqindjes

së gjobës brenda intervaleve të parashikuara në rregullore. Po kështu, mungesa e shembujve ilustrues në metodologjinë e propozuar nuk përbën në vetvehte mospërputhje me ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, pasi ky ligj nuk parashikon detyrimin për përfshirjen e tyre në aktin nënligjor përkatës.

Procesi i vendosjes së masës administrative me gjobë nuk përbën një vendimarrje individuale të inspektorit, por është pjesë e një procedure administrative të strukturuar, e cila zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike” dhe në harmoni me ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Në veprimtarinë inspektuese, diskrecioni administrativ është i pashmangshëm, pasi ligji kërkon vlerësim rast pas rasti. Ndërkohë, çdo vendim administrativ i AKEP është subjekt i procedurave të ankimit administrativ dhe gjyqësor, çka garanton kontrollin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të masës së vendosur.

Në përfundim, AKEP, vlerëson se pavarësisht se komentet mbi dokumentin e metodologjisë së përlllogaritjes së gjobave, lidhen kryesisht me qartësinë dhe mënyrën e zbatimit praktik të tij, me interpretimin e niveleve të shkeljes, përdorimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues, nga analiza e tyre rezulton se metodologjia e propozuar mbetet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton kuadrin dhe kufijtë maksimalë të sanksioneve dhe i delegon AKEP, kompetencën për të përcaktuar metodologjinë për këtë qëllim. Komentet e paraqitura nuk evidentojnë mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

QENDRIMI I AKEP MBI KOMENTET E SIPËRMARRËSIT “ONE ALBANIA” SH.A.

I. Të përfshihet një nen i posaçëm për dënimin administrativ "Paralajmërim", në përputhje me ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- 1. Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.*
- 2. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me paralajmërim.*
- 3. Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkates administrativ. Në këtë rast, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim".*
- 4. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa iv. Në rast shkeljesh të lidhura teknikisht, gjoba totale nuk duhet të kalojë tavanin e shkeljes më të rende, kjo sipas parimit të Unitetit të Veprimit.*

Qëndrimi i AKEP: AKEP vlerëson se propozimi edhe pse i arsyeshëm nuk qëndron në raport me ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i cili përcakton qartë në nenin 184 se shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative sanksionohen me gjobë, ndërkohë që paralajmërimi përdoret si instrument paraprak në raste të caktuara nga Këshilli Drejtues. Edhe

rregullorja e inspektimit referon këtë kuadër duke parashikuar se vendosja e masave administrative bëhet në përputhje me nenin 184 të ligjit organik. Gjithashtu, rregullorja nuk e përjashton paralajmërimin si instrument administrativ, por e përdor atë në mënyrë të kufizuar dhe të lidhur me procesin e vendimmarrjes së Këshillit Drejtues, në rastet kur subjekti duhet të korrigjojë shkeljen brenda një afati të arsyeshëm. Vendosja e një rregulli të përgjithshëm sipas të cilit çdo inspektim i parë do të përfundonte automatikisht me paralajmërim do të binte ndesh me parimin e efektivitetit dhe proporcionalitetit të sanksioneve, nevojën për garantimin e zbatimit të kuadrit rregullator, si dhe funksionin parandalues të sanksioneve.

I. Hapin II "Vlerësimi i masës së gjobës sipas kritereve të dhena në nenin 6 të Rregullores".

Përsa i përket shkeljeve të rëndësisë mesatare EDPB dhe Komisioneri përdorin diapazonin **10-20%**. Zgjerimi i këtij kufiri nga AKEP-i deri në 30% rrit ndjeshëm kufirin që shërben si pikënisje e gjobës për shkelje që nuk kualifikohen si "të larta", gjë që mund të çojë në sanksione joproporcionale, veçanërisht për operatorët me të ardhura të larta.

Për më tepër, vlerësimi i rëndësise nuk duhet të jetë një proces i thjeshtësuar. Ai kërkon analizën e pesë nën-faktorëve të poshtëshënuar:

- Natyra e shkeljes që do të thotë rëndësia e parashikimit ligjor të shkelur (p.sh. siguria e rrjetit vs. raportimi administrativ).
- Rëndësia e shkeljes, e cila ka të bëjë me numrin e pajtimtarëve të prekur dhe shkalla e dëmit financiar apo jofinanciar.
- Kohëzgjatjen, pra periudha nga fillimi i shkeljes deri në ndalimin e saj.
- Qëllimi, pra nëse shkelja është kryer me dashje (përfitim financiar i qëllimshëm) apo pakujdesi (gabim teknik/njerezor).
- Kategorite e të dhënave/shërbimeve, nëse preken shërbime thelbësore (urgjenca, integriteti kombëtar) apo dytësore.

Në bazë të arsyetimit të mësipërm, propozohet që në tabelën referuese, vlera e gjobës të jetë:

- 0% -10% (kategoria e ulët)
- 0% -10% (kategoria e mesëm)
- 20% -30% (kategoria e lartë)

Qendrimi i AKEP: Metodologjia e propozuar nga AKEP është në përputhje me parimet e vendosura nga ligji nr. 54/2024, pasi ligji përcakton vetëm nivelin maksimal të gjobës në raport me qarkullimin vjetor, duke i lënë AKEP kompetencën për të përcaktuar metodologjinë konkrete të vlerësimit. Kjo metodologji, i ndan shkeljet në 3 kategori (të ulëta, mesatare dhe të larta), duke përdorur një interval përqindjesh për të garantuar fleksibilitet në vlerësim, në varësi të rrethanave

konkrete të shkeljes. Zgjerimi i intervalit deri në 30% për shkeljet mesatare nuk nënkupton automatikisht një sanksion më të lartë, por krijon një hapësirë vlerësimi për rastet kur: shkelja ka ndikim më të madh në treg, prek një numër të konsiderueshëm përdoruesish, ose ka pasoja të ndjeshme për integritetin e rrjeteve. Në këtë mënyrë ruhet parimi i proporcionalitetit, pasi përqindja përfundimtare përcaktohet vetëm pas analizës së rrethanave konkrete.

Kufijtë në përqindje sipas udhëzimit të EDPB, nuk janë detyruese por udhëzuese, e në këto kushte, autoritetet mund të përdorin intervale të ndryshme mjafton që të respektohet parimi i proporcionalitetit në përcaktimin e gjobës si dhe gjoba të ketë karakter parandalues.

II. Hapi III "Aplikimi i faktorëve rëndues e lehtësues mbi masën e gjobës".

Përsa i përket aplikimit të faktorëve rëndues e lehtësues mbi masën e gjobës, projektregullorja propozon aplikimin e vlerave fikse prej (+/-10%) për faktorë si përsëritja, bashkëpunimi apo raportimi vullnetar. Kjo qasje me vlerë të parapërcaktuar për aplikimin e faktorëve lehtësues apo rëndues në vlerësimin për llogaritjen e masës së gjobës bie ndesh me udhëzimet e EDPB-se, të cilat theksojnë *'...duhet pasur parasysh se përlogaritja e masës së sanksionit nuk është thjesht një ushtrim matematikor. Përkundrazi, rrethanat e rastit specifik janë faktorët vendimtarë që përcaktojnë vlerën përfundimtare të sanksionit, që - në të gjitha rastet - mund të ndryshojë midis vlerës minimale dhe maksimale ligjore...'*

Sipas udhëzimeve të EDPB, pesha e faktorëve rëndues ose lehtësues duhet të varet nga efektiviteti i tyre në rastin konkret. Sa me sipër, ONE Albania propozon riformulimin e Hapit III dhe përditësimin si më poshtë:

Ndaj masës së gjobës të nxjerrë sipas hapave të mësipërm (I dhe II) mund të aplikohen faktorë të tjerë rëndues apo lehtësues, bazuar në sjelljen dhe aktivitetin e subjektit. Masa do rregullohet rast pas rasti pa aplikuar vlera fikse të paracaktura, dhe vlerësimi për vendosjen e masës duhet të përfshijë të gjitha rrethanat e arsyetuara në lidhje me kontekstin social-ekonomik në të cilin operon sipërmarrësi, ato që lidhen me kontekstin ligjor, si dhe ato që kanë të bëjnë me kontekstin e tregut.

Qendrimi i AKEP: Faktorët rëndues dhe lehtësues, të parashikuar në metodologjinë e gjobave të tilla si, përsëritja e shkeljes, manipulimi i provave, bashkëpunimi me autoritetin, raportimi vullnetar etj. synojnë të reflektojnë sjelljen e subjektit gjatë procedurës dhe të ndikojnë në përcaktimin e masës përfundimtare të gjobës. Vendosja e një vlere orientuese prej ($\pm 10\%$) siguron: parashikueshmëri për sipërmarrësit, trajtim të barabartë për raste të ngjashme, si dhe shmangie të arbitraritetit në vendimmarrje. Edhe në këtë rast, përqindja përfundimtare përcaktohet mbi bazën e vlerësimit të plotë të rrethanave të rastit.